



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE 2026

Lënda: Histori

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje** me **zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me **zhvillim dhe arsyetim**.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7
Pikët							
Pyetja	8	9	10	11	12	13	14
Pikët							
Pyetja	15	16	17	18	19	20	21
Pikët							
Pyetja	22	23	24	25	26	27	28
Pikët							
Pyetja	29	30	31	32	33		
Pikët							

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Qytet-shtetet greke ishin në mosmarrëveshje dhe konflikte ndërmjet tyre. Lufta e Peloponezit u zhvillua ndërmjet: **1 pikë**
- A) Spartës dhe Persisë.
B) Athinës dhe Spartës.
C) Greqisë dhe Romës.
D) Greqisë dhe Trojës.
2. Cili ishte sistemi i qeverisjes në qytet-shtetin e Spartës? **1 pikë**
- A) Oligarki.
B) Monarki.
C) Diktaturë.
D) Demokraci.
3. Ligji i heqjes së skllavërisë për borxhe në Athinë u ndalua nga: **1 pikë**
- A) Soloni.
B) Tezeu.
C) Klisteni.
D) Linurku.
4. Cili ishte ndikimi i pushtimeve romake në zhvillimin e qyteteve të tjera? **1 pikë**
- A) Romakët ndaluan çdo formë të zhvillimit në provinca.
B) Romakët krijuan shumë qytete të pavarura që u bënë nivele të Romës.
C) Romakët detyruan të gjithë qytetërimet të ndihmonin njëri-tjetrin në luftëra.
D) Romakët sollën zhvillim të infrastrukturës dhe krijuan rrugë të reja, duke lidhur qytetet e perandorisë.
5. Në fillim të shekullit IX, pushteti qendror bizantin forcoi pozitat e tij mbi trevat shqiptare dhe u bë një riorganizim administrativo-ushtarak në bazë theme. Në krye të saj qëndronte: **1 pikë**
- A) princi.
B) mbreti.
C) strategu.
D) sanxhakbeu.
6. Shteti që u vendos në krye të lëvizjes për bashkimin e Gjermanisë në shekullin XIX ishte: **1 pikë**
- A) Prusia.
B) Austria.
C) Polonia.
D) Danimarka.
7. Lëvizja për reformimin e kishës i pati fillimet e veta në: **1 pikë**
- A) Angli.
B) Zvicër.
C) Francë.
D) Gjermani.
8. Principata e Arbrit zinte një të tretën e trojeve të banuara nga arbrit dhe kishte simbolet e një shteti, si stema, vula, monedha etj. Qendra e saj ishte: **1 pikë**
- A) Kruja.
B) Vlora.
C) Durrësi.
D) Prizreni.

9. Pas prishjes së marrëdhënieve të Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik, vendet e perëndimit filluan tentativat për t'u afruar me Shqipërinë. Me cilin nga vendet e mëposhtme Shqipëria e kushtëzoi vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me kthimin e arit të bllokuar? **1 pikë**
- A) SHBA.
B) RFGJ.
C) Angli.
D) Itali.
10. Cila nga ngjarjet e mëposhtme i përket periudhës së qeverisjes së Napoleon Bonapartit? **1 pikë**
- A) Krijimi i Lidhjes së Shenjtë.
B) Krijimi i Bankës Kombëtare.
C) Krijimi i Aleancës Katërpalëshe.
D) Krijimi i perandorive shumëkombëshe.
11. Revolucioni i Parë Industrial u zhvillua për herë të parë në: **1 pikë**
- A) Angli.
B) Zvicër.
C) Spanjë.
D) Gjermani.
12. Një ndër shkaqet kryesore të shpërthimit të Revolucionit Francez ishte: **1 pikë**
- A) krijimi i Asamblesë Kombëtare.
B) reformat në drejtim të qeverisjes.
C) krijimi i Përfaqësive të Përgjithshme.
D) kriza financiare nga borxhet e mëdha.
13. Konventa ekonomike e vitit 1946 ishte një marrëveshje ekonomike që Shqipëria e nënshkroi me: **1 pikë**
- A) Greqinë.
B) Francën.
C) Jugosllavinë.
D) Bashkimin Sovjetik.
14. Qeverisja konstitucionaliste sipas ideve Iluministe afirmon: **1 pikë**
- A) sundimin në bazë të së "drejtës hyjnore".
B) sundimin sipas modelit të qeverisjes autokratike.
C) kufizimin e lirive e të drejtave themelore të individit.
D) garantimin e lirive e të drejtave themelore të individit.
15. Cili prej shteteve të mëposhtme kërkoi ndëshkimin më të ashpër të Gjermanisë në Konferencën e Paqes së Versajës pas Luftës së Parë Botërore? **1 pikë**
- A) Italia.
B) SHBA.
C) Franca.
D) Britania e Madhe.
16. Një ndër masat që u morën në Francë për rindërtimin ekonomik pas Luftës së Dytë Botërore ishte: **1 pikë**
- A) krijimi i kooperativave artizanale.
B) izolimi nga tregjet ndërkombëtare dhe investimi vetëm në bujqësi.
C) vendosja e ekonomisë së centralizuar dhe të planifikuar sipas modelit të BRSS- së.
D) mbështetja në ndihmën amerikane përmes Planit Marshall dhe reformat në industri.

- 17.** Në Traktatin e Fshehtë të Londrës (1915) Italia shprehu interesimin e saj të hapur për territoret e: **1 pikë**
A) Shqipërisë.
B) Bullgarisë.
C) Rumanisë.
D) Spanjës.
- 18.** Në Konferencën e Paqes në Paris pas Luftës së Parë Botërore, shteti që u paraqit me një vizion largpamës dhe idealist ishte: **1 pikë**
A) Italia.
B) SHBA.
C) Franca .
D) Jugosllavia.
- 19.** Lufta e Parë Botërore nisi me sulmin e: **1 pikë**
A) Gjermanisë kundër Francës.
B) Francës kundër Belgjikës.
C) Austrisë kundër Serbisë.
D) Austrisë kundër Italisë.
- 20.** "Doktrina Truman", e miratuar gjatë qeverisjes së presidentit Truman në vitin 1947 ishte: **1 pikë**
A) një ligj për të zgjeruar fondet për ushtrinë amerikane.
B) një plan që synonte rimëkëmbjen ekonomike të SHBA-së.
C) një marrëveshje tregtare, ekonomike me Bashkimin Sovjetik.
D) një ndihmë ekonomike dhe ushtarake për vendet që rrezikoheshin nga komunizmi.
- 21.** Cilat ishin tri nga shkaqet që çuan në fillimin e luftërave iliro-romake? **3 pikë**

- 22.** Jepni tri argumente mbi rëndësinë e Principatës së Arbrit. **3 pikë**

- 23.** Evidentoni tri nga shkaqet e përparimit të shpejtë të Perandorisë Osmane dhe suksesin e arritur në luftërat e tyre gjatë viteve '50 të shekullit XV, kryesisht në Ballkan. **3 pikë**

24. Jepni tri argumente pse krijimi i Kuvendit të Lezhës ishte një hap përpara drejt bashkimit politik dhe shoqëror të vendit. **3 pikë**

25. Në vitin 1861, në SHBA, filloi lufta civile mes shteteve të Jugut e shteteve të Veriut. Jepni tri arsye që ndikuan në fillimin e këtij konflikti. **3 pikë**

26. Figura e Ismail Qemalit ishte figura e një personaliteti që përmbledhte në shkallën sipërore të gjitha tiparet e një lideri të padiskutuar, që jetoi dhe veproi me forcën e mendjes dhe me zjarrin e një patrioti. Por rrethanat në të cilat ai drejtoi vendin si kryeministri i parë i shtetit modern shqiptar, do t'ia vështirësonin punët deri në dorëheqjen e tij dhe të qeverisë së tij në 22 janar 1914.

Cilat ishin tri nga rrethanat e vështira me të cilat do të përballlej Ismail Qemali dhe qeveria e tij?

3 pikë

27. Për t'ju përgjigjur pyetjes referojuni dokumentit të mëposhtëm:

Gjermania nuk ka hedhur sytë ndaj Prusisë për liberalizimin e saj, por për fuqinë që ajo ka. Për shtetet e jugut të Gjermanisë do të ishte e mjaftueshme kënaqja e disa aspiratave liberale, prandaj asnjëri nuk ua paracakton rolin e Prusisë atyre. Prusia duhet të mbledhë forcat e saj dhe t'i mbajë ato në rezervë për një rast të përshtatshëm. Që me traktatet e Kongresit të Vjenës kufijtë tanë kanë qenë të projektuar jo drejt për një shtet kombëtar të shëndetshëm. Çështjet e mëdha të kohës do të vendosen jo nëpërmjet fjalimeve dhe vendimeve të shumicës, por nëpërmjet gjakut e hekurit.

Fjalimi i kancelarit të Prusisë, Bismarkut, mbajtur më 29 shtator 1862 me zyrtarë të tjerë gjermanë.

- a) Identifikoni dy nga strategjitë që përdori Bismarku për bashkimin e Gjermanisë.

2 pikë

- b) Ku qëndron rëndësia e procesit të bashkimit të Gjermanisë?

1 pikë

28. Pas rrëzimit të regjimeve komuniste në vendet e Evropës Lindore, do t'i hapej rruga transformimeve të gjithanshme. Cili ishte thelbi i përbashkët i reformave në këto vende në aspektin ekonomik, të politikës së brendshme dhe asaj të jashtme. **3 pikë**

Në aspektin ekonomik:

Në aspektin e politikës së brendshme:

Në aspektin e politikës së jashtme:

29. Në Konferencën e Potsdamit, e zhvilluar më 17 korrik – 2 gusht 1945, u diskutua dhe çështja e krimeve që nazizmi kishte bërë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

- a) Çfarë u vendos lidhur me këtë çështje në Potsdam? **1 pikë**

- b) Cilat ishin dy ngjarjet kryesore që pasuan këtë konferencë në frontin aziatik? **2 pikë**

30. Cilët ishin tre treguesit kryesorë të krizës ekonomike botërore të njohur në histori si “depresioni i madh” në SHBA? **3 pikë**

31. “Më 8 nëntor 1960, rreth 108 milionë amerikanë iu drejtuan kutive të votimit. Nga votat e tyre, fitimtar doli Xhon F. Kenedi. Programi të cilin ai u propozoi amerikanëve nuk ishte një nga ato që mund të arrihej me dremetjen e rehatisë, ai kërkonte përpjekje, sakrifica dhe braktisje të shprehive komode.

Përshtatur nga “ Historia botërore dhe qytetërimi” Karl Grimberg

- a) Si u quajt programi qeverisës i Kenedit? **1 pikë**

- b) Shpjegoni nga një veçori të qeverisjes së Kenedit në politikën e brendshme dhe të jashtme.

2 pikë

Në politikën e brendshme:

Në politikën e jashtme:

- 32.** Gjysma e dytë e viteve '80 të shek. XX paraqet një periudhë shumë të vështirë për vendet e kampit komunist. Kriza ekonomike në të cilën kishin hyrë këto vende ishte e pariparueshme. Edhe në Shqipëri, Ramiz Alia në Kongresin IX të PPSH-së u shpreh se do të jetë vazhdues i trashëgimisë së Enver Hoxhës. Por pakënaqësia në rritje ndaj krizës së thellë ekonomike, e cila u rëndua edhe për shkak të izolimit të vendit, e detyroi Ramiz Alinë të merrte një sërë masash me natyrë politike dhe ekonomike për të zbutur gjendjen.

Përcaktoni një nga masat e marra për secilin nga aspektet: ekonomik, të politikës së brendshme dhe të politikës së jashtme.

3 pikë

Aspekti ekonomik:

Politika e brendshme:

Politika e jashtme:

- 33.** Njohja ndërkombëtare e shtetit shqiptar pas shpalljes së pavarësisë u arrit më 29 korrik 1913 në Konferencën e Ambasadorëve në Londër. Gjatë dhe pas luftës së Parë Botërore u rihap përsëri çështja e copëtimit të kufijve politikë të shteti Shqiptar dhe po vihej në pikëpyetje ekzistenca e këtij shteti. Por pas shumë diskutimesh, Konferenca e Paqes në Paris ia delegon zgjidhjen e çështjes shqiptare, Konferencës së Ambasadorëve në Paris e cila në 9 Nëntor 1921 merr vendimin përfundimtar për Shqipërinë. Krahasoni vendimet e këtyre dy konferencave bazuar në statutin politik të shtetit shqiptar dhe mbikëqyrjen ndërkombëtare.

4 pikë

Statusi politik i shtetit shqiptar:

Mbikëqyrja ndërkombëtare:
